



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna Klinë

Kryetari i Komunës

01 Nr. 06-33670/23
Klinë, datë: 25.09.2023

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik i përgjithshëm me qytetarë të Klinës, i cili u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal Klinë me datë 8 gusht 2023 dhe filloi në orën 17:30, ku morën pjesë: 9 persona.

RENDI I DITES

1. DRAFT PLANI I BUXHETIT KOMUNAL I KLINËS 2024 – 2026

Komuna e Klinës ka filluar debatet me publikun me takimin e parë të përgjithshëm me qytetarë në sallën e Kuvendit Komunal. Për pikën e rendit të ditës draft-plani i buxhetit komunal i Klinës 2024 – 2026, fjalën hyrëse e mori kryetari i komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj i cili ishte i shoqëruar nga përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu, drejtorë të tjerë të drejtorive si dhe grupi punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Kryetari Elezaj pasi përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi për pjesëmarrje në këto takime të rëndësishme dhe përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes, siç është Draft-plani buxhetor, pastaj ka bërë një prezantim për shifrat që do të këtë buxheti për vitin 2024.

Sipas ndarjeve në buxhet për vitin 2024 do të jetë rreth 15 milion euro. Rreth 50% të buxhetit do të shkojnë për kategorinë paga dhe mëditje, ku janë parapare rreth 7,893,500.00 euro. Komuna e Klinës ka paraparë që të shpenzoj 4,295,218.00 euro për investimet kapitale, për mallra dhe shërbime do të shpenzohen rreth 1,710,000.00 euro, Shërbime komunale 250,000.00 si dhe subvencione 500,000.00 euro. Ndërsa për projektet e planifikuara infrastrukturore si dhe synimet, kryetari Elezaj, theksoi se në qytet dhe fshatra po investohet në vazhdimësi. Ai përmendi disa nga projektet e rëndësishme siç janë investimet e pandalshme në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në komunën e Klinës, rregullimet e shtretërve të lumenjve Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës dhe lumin Klina të cilët rrezikohen nga vërshimet me daljen

nga shtrati, ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë, ndërtimi i parkut industrial për Klinë e shume shumë projekte që na presin të realizohen në vitin 2024.

Pas kryetarit, përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu, ju dha fjalën qytetarëve pjesëmarrës për të diskutuar lidhur me atë që u prezantua nga ana e kryetarit Elezaj si dhe ndarjen e nevojave dhe kërkesave të zonave kua ata jetojnë apo edhe ndarjen e sugjerimeve që ata kanë lidhur me buxhetin e viti 2024.



Qytetarët pjesëmarrës gjatë takimit nuk parashtruan asnjë kërkesë apo sugjerim lidhur me Draft-Plani e Buxhetit Komunal të Klinës 2024 – 2026.

Takimi përfundoi në orën 18:05.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	9
Total:	9

Procesmbajtësi:

Vlora Tafili

Klinë, datë:

